



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 397/24 Dt. 28.06.2024



Republika e Kosovës

Komuna e Prizrenit

Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Raporti i punës së kryetarit – Janar-Qershor 2024

Qytetarë të dashur,

Kuvendarë e drejtorë të nderuar,

Përmirësimi i jetës së qytetarëve tanë ka qenë dhe është synimi e vizioni ynë kryesor, prandaj po punojmë çdo ditë, me vullnet, me intensitet dhe me përkushtim, për ta përmbushur këtë vizion.

Suksesi ynë nuk do ishte i mundshëm dhe nuk do ishte i përmbushur pa mbështetjen e qytetarëve tanë, prandaj falënderoj secilin për durimin që punët e mira t'i shohin dalëngadalë dhe për mbështetjen e vazhdueshme. Bashkë po vazhdojmë udhëtimin për zhvillimin e Komunës sonë.

BASHKË PËR PRIZRENIN.

Transparenca, llogaridhënia, ngritja e performancës komunale tashmë janë standard i arritur në Komunën tonë.

Infrastruktura moderne, hapësirat e gjelbëruara, jeta aktive kulturore e sportive, hapësirat e lira publike kanë bërë që Komuna jonë tashmë të merr pamje më funksionale, të duket më bukur dhe të jetë e vizituar nga shumë njerëz për eventet kulturore, artistike dhe sportive.

Prioritete shumë të rëndësishme për ne, për të cilat jemi duke punuar intenzivisht, janë turizmi i zhvilluar, arsimi cilësor, shërbimet shëndetësore gjithëpërfshirëse e ndihma për bujqit; me përgjegjësi të plotë kemi adresuar suksesshëm shumicën e kërkesave dhe nevojave të qytetarëve të Komunës sonë.

Jemi zgjedhur nga qytetarët, po punojmë me qytetarët dhe për qytetarët; me fokus në përmbushjen e kërkesave me interes të përgjithshëm publik.

Tashmë, duke u renditur e para në listën e Komunave më Transparente të Republikës, kemi dëshmuar se politika jonë bazohet në transparencë, llogaridhënie, qasje proaktive dhe punë për qytetarët e me qytetarët tanë.

Takimet dhe aktivitetet

Vazhdojmë t'i takojmë qytetarët, OJQ-të, mediat, institucionet publike e ambasadat. Me të gjithë kemi krijuar marrëdhënie të mira dhe korrekte. Gjatë gjithë këtyre viteve kemi pritur OJQ, ambasadorë dhe përfaqësues të misionëve diplomatike me të cilët kemi zhvilluar projekte dhe kemi bashkëpunim për ta zhvilluar kulturën, sportin, ambientin dhe projekte në sfera të ndryshme.

Kemi pasur takime dhe pritje në zyre të shumë organizatave joqeveritare, personaliteteve të shquara, të institucioneve vendore e të huaja dhe delegacione të ndryshme vendore, ndërkombëtare e diplomatike.

Përveç takimeve të lartcekura, gjithashtu janë mbajtur edhe shumë takime me deputetë, OJQ dhe shoqata të ndryshme, klube sportive, takime me KFOR-in, pjesëmarrje në tryeza me ftesë nga niveli qendror apo lokal, përrurime të investimeve kapitale në Prizren, pjesëmarrje në shumë aktivitete, takime individuale me qytetarë.

Memorandumet e nënshkuara:

1. Memorandum bashkëpunimi ndërmjet MPBZHR, MAPL dhe KK Prizren – 12.01.2024;
2. Memorandum bashkëpunimi ndërmjet KK Prizren dhe Concordia - 13.02.2024;
3. Marrëveshje financimi ndërmjet KK Prizren dhe UNDP – 14.02.2024;
4. Marrëveshje për bashkëfinancim me “ESNAF” për projektin “Ndërtimi i objektit administrativ për nevojat e zejtarëve” – 20.02.2024;
5. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet KK Prizren dhe KRU “Gjakova” – 14.03.2024;
6. Memorandum mirëkuptimi ndërmjet KK Prizren , PPSE dhe SËISS Contact – 18.03.2024;
7. Marrëveshje bashkëfinancimi ndërmjet KK Prizren dhe KRU “Hidroregjioni” – 20.03.2024;
8. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet KK Prizren dhe AZHR Jug – 22.03.2024;
9. Marrëveshje bashkëfinancimi ndërmjet KK Prizren, ITP dhe Makerspace – 26.03.2024;
10. MOU me OSBE-në për institucionalizimin koordinues kundër dhunës në familje – 28.03.2024;
11. MOU me ITP dhe Makerspace – 03.04.2024;
12. Memorandum bashkëpunimi ndërmjet KK Prizren dhe Preda Plus, Integra – 19.04.2024;
13. MOU ndërmjet KK Prizren dhe Shoqatës Sindikale të Shërbyesve Civil – 08.05.2024;
14. MOU KK Prizren, Allianz Foundation dhe Autostrada Biennale – 31.05.2024.



RAPORTET E PUNËS SË ZYREVE TË KRYETARIT

1. Zyra për Integritet Evropian.

Gjatë periudhës raportuese Janar – Qershor 2024 është bërë sigurimi i implementimit për zbatimin e obligimeve të Komunës nga Agjenda Evropiane për veprimet që ndërlidhen me komunën dhe raportimi sipas kërkesave të MAPL-së.

Sipas kërkesës së MAPL-së janë mbledhur të gjitha informatat e kërkuara nga secila drejtori në lidhje me zbatimin e obligimeve të komunës nga Agjenda Evropiane 2024 për PKZMSA (Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit).

Pjesëmarrja në trajnimin “Parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative” i organizuar nga IKAP - GIZ dhe certifikimi.

Pjesëmarrja në sesione informuese për thirrjet e programeve të BE-së.

2. Zyra për Informim

Njësia për Komunikim me Publikun, gjatë periudhës raportuese gjashtë muajore ka lekturuar, përkthyer në gjuhët zyrtare (Turqisht, Boshnjakish) dhe ka publikuar në ueb faqe të komunës të gjitha vendimet e Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit.

Vendimet e kryetarit janë publikuar në vegëzën vijuese: <https://kk.rks.gov.net/prizren/category/vendimet-e-kryetarit/>

Vendimet e Kuvendit të Komunës i gjeni të bashkëlidhura në vegëzën: <https://kk.rks.gov.net/prizren/category/vendimetregulloret/vendimet/>

Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi pranuar 74 kërkesa për Qasje në Dokumente Publike, ku të gjitha kërkesave u është dhënë përgjigje dhe duke ofruar dokumentet në afate ligjore.

Në muajin Maj Instituti Demokratik i Kosovës ka publikuar Transparimetrin Komunal “Vlerësimi i Transparencës së komunave të Kosovës për vitin 2023”. Në këtë vlerësim komuna jonë është renditur e para në nivel kombëtar. Pra, Komuna e Prizrenit për herë të parë që nga pas lufta, është renditur si komuna me transparente, në garë më 38 komuna tjera të Republikës së Kosovës.

Raportet financiare periodike (tre muajore) dhe raporti vjetor financiar është publikuar në ueb faqe dhe sipas afateve ligjore i gjeni në vegëzën: <https://kk.rks-gov.net/prizren/financa/financa-2/>

Vazhdojmë ta mbajmë të hapur linjën telefonike të thirrjeve pa pagesë për qytetarët e komunës sonë dhe të gjitha pyetjet, kërkesat dhe sugjerimet e tyre adresohen për zgjidhje në zyrat përkatëse.

3. Zyra Ligjore

Gjatë kësaj periudhe janë hartuar dhe janë proceduar për nënshkrim te Zyra e Kryetarit të Komunës në total 282 vendime 9 autorizime deri me 11.06.2024:

1. Janar: 21 vendime dhe 3 autorizime
2. Shkurt: 104 vendime dhe 2 autorizime
3. Mars: 70 vendime dhe 2 autorizime
4. Prill: 18 vendime dhe 2 autorizime
5. Maj: 48 vendime dhe 0 autorizime
6. Qershor: 21 vendime dhe 0 autorizime

4. Sektori për Çështje Pronëso-ro-Juridike

Në periudhën Janar-Qershor 2024, Sektori për Çështje Pronëso-ro-Juridike ka pranuar gjithsejtë - 303 lëndë, prej të cilave në afatin e paraparë ligjor janë shqyrtuar dhe aprovuar 271 lëndë, janë refuzuar 23 lëndë, ndërsa 9 lëndë janë në procedurë e sipër.

- Procedura e shpronësimit të plotë dhe jo të plotë-servituti dhe procedura lidhur me bartjen administrative (kjo procedurë është zhvilluar në emër të Kryetarit të Komunës, në pajtim me Ligjin Nr.03/L-139 - Lëndë të arritura – 1, të kryera – 0, në procedurë e sipër – 0, refuzuara - 1.
- Procedura lidhur me përpilimin e kontratave mbi qiranë për lokalet pronë e KK Prizrenit dhe kontrolli lidhur me përmbushjen e obligimeve që dalin nga to. Lëndë të arritura – 260, Kontrata të lidhura - 0, Vërejtje - 23, Vërejtje para padisë - 20, kërkesa - 216, njoftime dhe vendime - 1, ekzekutime - 0 dhe konkluzion mbi ekzekutim - 0.
- Procedura lidhur me vërtetimin dhe konstatimin e uzurpimit arbitrar të tokës në pronësinë shoqërore. Lëndë të arritura dhe të bartura – 7, konkluzione për ndërprerjen e procedurës – 0, njoftime mbi ndërprerjen e procedurës – 0, aktvendime të kryera – 5, lëndët në procedurë e sipër – 2.
- Kërkesa të ndryshme - njoftime për Gjykatën Komunale, Asamblenë, palëve dhe për Përfaqësuesin e Komunës - gjithsejtë të arritura – 35 lëndë.

5. Zyra e Auditimit

Rezultatet kryesore/të arriturat për periudhën raportuese:

Nga katër (4) detyra audituese dhe një (1) detyrë për përcjelljen e zbatueshmërisë së rekomandimeve, të planifikuara për periudhën janar-qershor 2024, deri në kohën e përgatitjes së këtij raportit (10 qershor), janë finalizuar katër (4) raporte dhe një (1) detyrë audituese është në process.

Janë realizuar këto detyra audituese:

- Raporti mbi rishikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NjAB për vitin 2023, është dhënë një (1) rekomandim;
- Zbatimin e procedurave lidhur me identifikimin evidentimin, klasifikimin, barazimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë së komunës në libra e pasurisë (në DBF), janë dhënë tri (3) rekomandime;
- Rregullsitë e procesit të planifikimit dhe inkasimi i të hyrave nga bashkëpagesat (participimi) në Drejtorinë e Shëndetësisë, është dhënë një (1) rekomandim;
- Rregullsitë lidhur me kalkulimin e detyrimeve dhe grumbullimin e të hyrave nga tatimi në pronë dhe tokë, janë dhënë dy (2) rekomandime;
- Menaxhimi i shpenzimeve për mallra, shërbime dhe të komunalive në Administratën e Komunale, është në proces.

Gjithashtu në kuadër të objektivave të përcaktuara, NjAB ka realizuar edhe këto aktivitete audituese:

- Bashkërendimi i auditimit me ekipin e ZKA (Zyra Kombëtare e Auditimit) për periudhat që kanë audituar në Komunën tonë (shkurt – mars 2024) dhe koordinimi i aktivitete lidhur me drastraportin e ZKA-së;
- Raportet vjetore për Kryetarin e Komunës, Komitetin e Auditimit dhe NjQHAB/MFPT:
- Periudha e raportimit: Raporti vjetor për vitin 2023 (koha e raportimit, janar 2024).

6. Zyra e Burimeve Njerëzore

Nga periudha 01.01.2024 deri më 06.06.2024 ka pranuar (treqind e nëntëdhjetë e dy) 392 kërkesa, të cilat janë shqyrtuar dhe një pjesë e tyre janë në proces sipas procedurës.

Shkresat dhe komunikimet elektronike janë 763.

Numri i konkurseve të shpallura për nëpunës të shërbimit civil për periudhën e raportimit është 14, prej të cilëve:

- 14 janë shpallur për pranim në shërbimin civil, ku 4 prej tyre kanë përfunduar me sukses dhe janë plotësuar me staf, 2 të dështuara pa kandidatë të suksesshëm dhe 8 janë në procedurë.

Numri i konkurseve të shpallura për nëpunës të shërbimit publik është 3 me gjithsej 20 pozita prej të cilëve:

- Në Shëndetësi: 3 konkurse me 20 pozita, prej tyre: 2 konkurse me 14 pozita kanë përfunduar me sukses, 1 konkurs me 6 pozita në procedurë;

Aktivitete të tjera:

- Kemi pritur në monitorim KPMSHCK-në, ku monitorimi është kryer me realizim të vizitës në Komunë, është bërë përzgjedhja e mostrave, rishikimi i dokumenteve dhe verifikimi fizik i tyre dhe pas këtij Monitorimi KPMSHCK-ja ka marrë vendim me vetëm 2 rekomandime që konsiderohet që zbatimi i ligjshmërisë lidhur me procedurat e shërbimit civil ka qenë në nivel të lartë.
- Komisioni i ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik dhe Nëpunësit Administrativ/Mbështetës në Komunën e Prizrenit ka pranuar gjithsej 11 ankesa prej të cilave: 11 janë refuzuar si të pabazuara, 1 është pjesërisht e aprovuar.
- Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Publik ka zhvilluar gjithsej 5 procedura disiplinore dhe janë marrë këto masa: 1 (një) kërkesë është hedhur poshtë, 2 (dy) zyrtarëve i është dhënë masa për ndalesë në pagë, 2 (dy) zyrtarëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës. Ndërsa Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Civil ka zhvilluar 1 (një) kërkesë e cila është hedhur poshtë.
- Për Nëpunësit teknik dhe mbështetës janë zhvilluar gjithsejtë 4 procedura disiplinore dhe janë marrë këto masa: 1 (një) nëpunësi i është dhënë masa për ndalesë në pagë, 2 (dy) nëpunësve u është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe 1 (një) është në procedurë.

7. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Aktivitetet kryesore:

- Ngritja e mirëqenies të komuniteteve minoritare/Shpërndarja e pakove ushqimore-higjienike - 48 familje;
- Kthimi i personave të zhvendosur nga regjioni;
- Shpërndarja e granteve me përfaqësuesin e IOM-it, ZKKK-ja ka marrë pjesë gjatë shërndarjes së granteve për përkrahjen e bizneseve. Gjithsejtë kanë përfituar 5 familje boshnjake dhe dy raste nga komuniteti rom;
- Riintegrimi i personave të riatdhesuar - deri në fund të muajit Maj nuk ka asnjë rast të ri të riatdhesuar;
- Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur gjithësejtë tri takime të Komitetit Komunal për Riintegrim (KKR), janë aprovuar 6 kërkesa për vazhdim të akomodimit;
- Sipas marrëveshjeve të komunës, ZKKK-ja vazhdon bashkëpunimin me organizatat vendore dhe ndërkombëtare si në vijim: OSCE, UNHCR, UNMIK, IOM, AT, etj.;
- ZKKK-ja deri më tani ka lëshuar gjithsejtë 215 vërtetime për shërim jashtë vendit për komunitetin turk në Republikën e Turqisë;
- Janë mbajtur trajnime të gjuhës angleze me Organizatën “Peace Corps” për të rinjtë nga radhët e komuniteteve minoritare, ku janë pajisur me certifikatë 16 të rinj.



Foto nga shpërndarja e certifikatave me Organizatën “Peace Corps”

- Sipas planit të punës, ZKKK-ja ka mbajtur edhe takimi me të gjitha komunitete minoritare.



Fotot nga takimi i ZKKK-së me komunitetet

8. Zyra e Prokurimit

Aktivitetet kryesore:

- Deri më 13. 06 2024 janë shpallur tenderë për punë, shërbime dhe furnizime, të vlerave të vogla, të mesme dhe të mëdha - gjithsejtë 100 projekte;
- Janë nënshkruar gjithsejtë 95 kontrata të vlerave të vogla, të mesme dhe të mëdha;
- Janë nënshkruar 2 aneks kontrata për kontratat bazë të vitit të kaluar;
- Janë në proces të hapjes dhe vlerësimit edhe 35 lëndë;
- Në proces të ankimimit për vitin 2020 deri në këtë datë janë gjithsejtë 7 lëndë.

RAPORTI PUNËS SIPAS DREJTORIVE

1. Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave

Spektori për Buxhet dhe Thesar gjatë periudhës Janar – 10 Qershor 2024 ka ekzekutuar pagesat për 1,627 lëndë, po ashtu ka bërë zotimin e 794 lëndëve. Po në të njëjtën kohë për 1.035 lëndë ka bërë pranimin e mallit në sistem dhe ka bërë aprovimin e lëndëve për mjetet e zotura për 1.627 lëndë.

Raporti i shpenzimeve sipas kategorive – janar – 10 qershor 2024:

Kategoria	Planifikimi	Shpenzimet	Përqindja
Pagat	26,429,860.78	11,799,075.39	44.64 %
Mallrat dhe shërbimet	12,917,748.00	4,586,875.16	35.51 %
Shpenzimet Komunale	1,001,267.21	378,944.09	37.85 %
Subvencionet	4,080,234.45	1,677,647.87	41.12 %
Investimet Kapitale	23,393,734.78	7,555,721.53	32.30 %
Gjithsejtë	67,822,845.22	25,998,264.04	38.33 %

Të hyrat vetanake komunale sipas drejtorive për periudhën janar – 10 qershor 2024

Kodi	Drejtoria	Planifikimi	Të Hyrat	Diferenca	Indexi
16310	Administrata dhe Personeli	445,000.00	178,585.83	-266,414.17	40.13%
16619	Inspeksioni	55,000.00	8,010.30	-46,989.70	14.56%
17510	Ekonomi, Financa dhe Zhvillim	3,203,294.00	1,360,997.51	-1,842,296.49	42.49%

18010	Shërbime Publike, Mbrojtje civile, Emergjenca	3,180,000.00	1,154,170.14	- 2,025,829.86	36.29%
47010	Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	30,000.00	0.00	-30,000.00	0.00%
65050	Kadastër dhe Gjeodezi	500,000.00	177,810.00	-322,190.00	35.56%
66055	Planifikim Urban dhe Mjedis	2,060,000.00	1,153,140.79	-906,859.21	55.98%
73600	Shërbimet e kujdesit primar Shëndetësor	230,000.00	111,382.25	-118,617.75	48.43%
85010	Kulturë, Rini, Sport	20,000.00	2,114.00	-17,886.00	10.57%
92050	Arsimi dhe Shkenca - Administrata	470,000.00	85,612.50	-384,387.50	18.22%
	Gjithsejtë	10,193,294.00	4,231,823.32	- 5,961,470.68	41.52%

Për vitin 2024 janë planifikuar të hyra 10,193,294.00 € kurse për këtë periudhë janë mbledhur të hyra vetanake 4,231,823.32 € apo 41.52 % nga planifikimi.

- Sektori i Tatimit në Pronë për periudhën Janar – 10 Qershor 2024: janë shpërndarë 34,008 fatura për tatimpaguesit. Nga ky sektor janë realizuar të hyra në shumën prej 1.360.945.51€, janë regjistruar 859 objekte të reja dhe janë verifikuar 673 objekte ekzistuese. Po ashtu, ky sektor ka pranuar dhe shqyrtuar 563 ankesa për pronën e paluajtshme.

Gjatë periudhës Janar – 10 Qershor 2024 Qendra për Regjistrimin e Bizneseve ka kryer këto punë: regjistrime të reja 423, ndryshime 290, shuarje 46, informatat e biznesit 375, njoftim mbi shuarjen 2, historiku 3, duplikat 3, vërtetime 21, ndryshime të certifikatave 58, etj.

2. Drejtoria e Shërbimeve Publike

Drejtoria për Shërbime Publike gjatë vitit 2024 bazuar në planifikimin buxhetor si dhe planit të punës, ka paraparë shumë projekte të reja përveç atyre ekzistuese që janë në implementim. Rreth 50 projekte që vazhdojnë nga vitet paraprake.

Për për Drejtorinë e Shërbimeve Publike janë planifikuar për Investime Kapitale 12,710,000.00€ nga të cilat mjete nga granti qeveritar janë 10,610,000.00 € dhe 2,100,000.00 € nga të hyrat vetanake.

Në kategorinë Mallra dhe Shërbime në Drejtorinë e Shërbimeve Publike është paraparë buxhet në vlerë prej 3,089,662.00€

Përveç këtij buxheti nga të hyrat e bartuara nga viti 2023, Drejtoria ka përfituar fondin në vlerë prej 2,422,452.64 €.

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria për Shërbime Publike ka nënshkruar 13 kontrata të reja në vlerë prej 11,494,724.10 Euro. Mbi 10 projekte janë në fazën tenderuese, ndërsa, janë marr 19 vendime për fillimin e procedurave për implementimin e projekteve kapitale. Deri në fund të këtij viti pritet të nënshkruhen edhe disa kontrata të reja.

Në Periudhën Janar – Dhjetor, deri më tani për investime kapitale janë shpenzuar rreth 5,035,353.95 € për kategorinë ekonomike të investimeve dhe 1,138,300.09€ për kategorinë mallra dhe shërbime.

Disa prej projekteve që janë në realizim e sipër:

1. Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve me asfalt;
2. Rregullimi i infrastrukturës në lagjen Dardania 2 (projekt 2 vjeçar) - Lot 2 - Degëzimi të udhëkryqi gjatësia Aksi1 L=568.52m, B=14.00m; Aksi2 L=356.40, B=9m;
3. Ndërtimi i infrastrukturës në lagjen Jeta e Re - rruga Agim Bajrami te Hekurudhat;
4. Rregullimi i infrastrukturës në lagjen Dardania 2 – LOT 1;
5. Ndërtimi i infrastrukturës të shkollës së Dardanisë;
6. Rregullimi i trotuareve në unazën e qytetit të Prizrenit;
7. Ndërtimi i rrugës Velezhë – Smaç;
8. Ndërtimi i infrastrukturës në lagjen Arbana;
9. Ndërtimi i infrastrukturës në Korishë – projekt dy vjeçar;
10. Rehabilitimi dhe rivitalizimi i hapësirave publike në zonën e parë të mbrojtur në pjesën e vjetër të qytetit, restaurimi i shesheve dhe objekteve - projekt trevjeçar;
11. Ndërtimi i rrugës Qafa e Kushninit - Stanet e Struzhës;
12. Ndërtimi i ujësjellësit dhe rezervuarit në fshatin Lubizhdë e Prizrenit - projekt dyvjeçar;

- 13.Rregulimi i infrastrukturës në rrugën Ersan Mazreku – projekt dyvjeçar;
- 14.Ndërtimi i kanalizimit dhe rrugëve në Skorobisht – projekt dyvjeçar;
- 15.Ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Karashëngjergj - projekt dyvjeçar;
- 16.Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Landovicë;
- 17.Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Randobravë - projekt dy vjeçar;
- 18.Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në zonën Nënkala - Komuna e Prizrenit - projekt dy vjeçar;
- 19.Ndërtimi i infrastrukturës në Planejë - Gorozhup, ndërtimi i rrugës në lagjen Stajku;
- 20.Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në rrugën Nëna Terezë në Prizren - projekt dyvjeçar;
- 21.Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësve jashtë pronës private në fshatin Zhur;
- 22.Ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Zym - kanalizim dhe rrugë - projekt dyvjeçar;
- 23.Ndërtimi i rrugës transitore dhe kryqëzimi me autostradën në Prizren - projekt dyvjeçar;
- 24.Rregullimi i ndriçimit publik në fshatin Lubizhdë e Hasit - projekt dyvjeçar;
- 25.Ndërtimi i ndriçimit publik në Korishë;
- 26.Ndërtimi i infrastrukturës në Nashec (rrugë, kanalizim dhe ujësjellës) – projekt dy vjeçar;
- 27.Ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Landovicë;
- 28.Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në fshatin Poslisht;
- 29.Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në fshatin Kabash, Has;
- 30.Asfaltimi i rrugës në Kobajn e Vjetër;
- 31.Furnizimi me zhavor për rrugët e pa asfaltuara në Komunën e Prizrenit;
- 32.Ndërtimi i infrastrukturës (rrugë, kanalizim, ujësjellës) në Lagjen e Trimave (Tusus);

Sektori Mjedisit dhe Menaxhimi Mbeturinave

Sektori i mjedisit dhe menaxhimit të mbeturinave po punon në ndërtimin e shumë parqeve për të krijuar kushte më të mira mjedisore për qytetarët.

Disa prej projekteve që janë në realizim e sipër:

Projekt 1: “Menaxhimi i mbeturinave, grumbullimi, transporti dhe deponimi në Komunën e Prizrenit”;

Projekti 2: Riparimi dhe mirëmbajtja investive e rrugëve (fshirja dhe larja e rrugëve) në Komunën e Prizrenit” - zona I + II;

Projekti 3: "Riparimi dhe mirëmbajtja investive e rrugëve (fshirja dhe larja e rrugëve) në Komunën e Prizrenit – zona III”;

Projekti 4: Rregullimi i 4 parqeve (Kemajl Ataturk, Parku te Semaforat, Parku te Yllka, Parku

Ramë Bllaca);

3. Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës

Aktivitetet kryesore:

Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollave

Është duke vazhduar përzgjedhja e personelit udhëheqës të shkollave. Përgjatë vitit 2024 është rishpallur konkursi për drejtorë në shkollat “Brigada 125” në Medvec dhe “22 Dëshmorët” në Randobravë.

Në muajin maj 2024 është mbajtur punëtori për “Planin zhvillimor të arsimit në Komunën e Prizrenit”.

Është hapur thirrja për digjitalizimin e sistemit të arsimit në DKA - është në fazën e prokurimit të shërbimeve, që pritët të fillohet në fillim të vitit shkollor.

Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

Është nisur procesi i identifikimit të institucioneve parashkollore private. Janë mbajtur disa takime koordinuese me Inspektoratin e Arsimit, ku janë duke u koordinuar vizitat dhe mbledhja e të dhënave.

DKA-ja, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Caritas Kosova për të vazhduar me dhënien e shërbimeve profesionale psikologjike për fëmijët me nevoja të veçanta. Gjithashtu, vazhdon bashkëpunimi edhe me organizatat e tjera ndërkombëtare (Unicef, SCIK, etj) për t’i përmirësuar shërbimet arsimore për nxënësit në nevojë.

Është funksionalizuar institucioni i edukimit të hershëm në lagjen Bajram Curri. Është përzgjedhur udhëheqësi, është bërë planifikimi buxhetor, angazhimi i personelit dhe po bëhet përgatitja për hapjen solemne në fillim të vitit shkollor.

Përmes garave dhe aktiviteteve të tjera ndërkulturore është duke u promovuar multikulturalizmi dhe diversiteti në arsimin parauniversitar.

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve

Bashkë me shkollat janë identifikuar nevojat për zhvillim profesional të personelit arsimor dhe bazuar në kërkesat e shkollave DKA-ja është në fazën e përgatitjes së projektit për thirrjen e shërbimeve për zhvillim profesional.

Shkollat janë duke organizuar trajnime profesionale me buxhetet që i kanë, derisa përmes organizatave të tjera janë duke u organizuar trajnime në fushat deficitare si mësimdhënia e digjitalizuar, mësimdhënia produktive, PIA, etj.

Zbatimi i kurrikulës së re

Është intensifikuar shërbimi i këshillëdhënies për shkollat lidhur me zbatimin e KKK-së. Përmes drejtorëve dhe koordinatorëve të cilësisë shkollat marrin këshilla nga DKA-ja për modalitetet e zbatimit të KKK-së, për sfidat e zbatimit dhe për zgjidhjet e mundshme të problemeve ad-hoc të zbatimit të KKK-së. Gjithashtu, shkollat vazhdimisht furnizohen me materiale pune, me udhërrëfytes dhe dokumentacion relevant për zbatimin e KKK-së.

Sigurimi i cilësisë

Vazhdon përkrahja e koordinatorëve të cilësisë me bazë në shkolla. Përmes MASHT-it dhe agjencive zhvillimore koordinatorët e cilësisë me bazë në shkollë kryejnë trajnime relevante dhe ndërtojnë kapacitete për zbatim të KKK-së dhe ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënës në shkollat e komunës.

Gjithashtu, vazhdon renovimi i shkollave dhe ndërtimi i shkollave të reja në mënyrë që të plotësohen nevojat e bazuara në kërkesa.

Meqenëse është duke u shtuar përdorimi i mjeteve digjitale në funksion të mësimdhënies dhe nxënies, DKA-ja ka hapur thirrje për furnizim me tabela të mençura dhe pajisje të tjera digjitale.

Në bashkëpunim me Policinë e komunitetit janë mbajtur ligjerata me nxënës dhe personelin arsimor në 32 shkolla lidhur me sigurinë.

Aktivitetet shitesë:

- Dita e Pavarësisë së Kosovës - Është përgatitur aktiviteti edukativo-sportiv “Olimpiada e Pavarësisë” me nxënës në 15 disiplina në stadiumin e qytetit;
- 7 marsi - Është organizuar program artistik nga DKA-ja për nder të Ditës së Mësuesit, ku janë shpërndarë mirënjohje dhe dhurata për mësuesit e pensionuar;
- Test ndërkombëtar TIMSS me 13 shkolla me nxënësit e klasave të pesta – rezultatet janë në pritje.
- Testi i Arritshmërisë – Përgatitja e organizimit të Testit të Arritshmërisë për vitin shkollor 2023-2024 i cili mbahet më 25 qershor dhe 28 qershor 2024. 2053 nxënës do t'i nënshtrohen testit.
- Testi i Maturës – Përgatitja e organizimit të Testit të Maturës për vitin shkollor 2023/2024, i cili mbahet më 22 qershor 2024.

- Vizita në të gjitha shkollat e mesme të larta për t'i kontrolluar dokumentet pedagogjike dhe administrative;

Trajnime, punëtori dhe punë në ekip:

- Punëtori për krijimin e Planit Zhvillimor të Arsimit 2024-2027;
- Pjesëmarrje në punëtorinë për të drejtat e fëmijëve;
- Pjesëmarrje e mësimitdhënësve në trajnimin me temën “Siguria në shkolla”;
- Punëtori për akomodimin e të Riatdhesuarve;
- Takim i komisionit për komunitetin Rom – Ashkali – Egjiptian, pranë Kuvendit Komunal;
- Organizimi i procesit mësues në mësimin jo formal. Ky proces në Komunën e Prizrenit është bërë për herë të parë;
- Mbikëqyrja e planeve të punës dhe procesit edukativo - arsimor;
- Kontrollimi i funksionimit të organeve të shkollës etj;
- Bashkëpunimi me prindër, Ekipet e EPRBM të shkollës, këshilli i prindërve dhe këshilli i nxënësve;
- Monitorimi i 35 shkollave për ta kontrolluar plotësimin e standardeve për krijimin e mjedisit gjithëpërfshirës të përshtatshëm të mësimitdhënies dhe të nxënësve;
- Kontrollimi i orarit të ndjekjes ditore dhe javore të mësuesve në shkolla;
- Vlerësimi i brendshëm i shkollës në shkallë kurrikulare – “Monitorimi i nxënësve të shkollave të Komunës së Prizrenit”;
- Vlerësimi i brendshëm - Kontrollimi i dokumenteve të koordinatorëve të cilësisë së shkollave;
- Kontrollimi i vlerësimit të brendshëm të shkollave;
- Vlerësim i brendshëm i performancës së drejtorëve të shkollave “Hasim Maliqi” dhe shkollës “Zenun Çoçaj”;
- Monitorimi i funksionimit të mjeteve teknologjike në 22 shkolla;
- Furnizimimi me robotë në 43 shkolla;
- Pjesëmarrja në garën KOSOVA MAKERS LEAGUE OPEN 2023–‘24;

Trajnime:

- Trajnimi i mësimitdhënësve me temë “Super shkolla”
- Trajnimi i mësimitdhënësve me temë “Metodologji interaktive e mësimitdhënies”;
- Trajnimi i mësimitdhënësve me temë “Planifikimi i mësimitdhënies produktive”;
- Ëorkshop “Skills sustainable jobs in Kosova”;

Subvencionet:

- Për vitin shkollor 2023/24 DKA-ja, me mbështetjen e Kryetarit të Komunës, ka rritur numrin e bursave në 170. Vlera e bursës për studentë është 700 Euro.
- Për vitin shkollor 2023/24, DKA-ja ka ndarë 134 bursa nga 300 Euro për nxënës të shkollave të mesme, për fëmijët e invalidëve të luftës, veteranëve, rasteve sociale dhe nxënësve udhëtarë.

Investimeve kapitale:

1. Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Pllanjanë" në Pllanjanë (I përfunduar);
2. Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" (ish 'Pjetër Mazrreku') në Mazrrek. Punimet do të zgjasin deri në vitin 2025;
3. Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Krushë të Vogël - faza e parë. Objekti sipas planifikimit do të jetë në funksion gjatë vitit 2025;
4. Ndërtimi i objektit të ri shkollor (9 vjeçare) në Gjonaj të Hasit (I përfunduar);
5. Ndërtimi i aneksit të objektit shkollor "Ardhmëria" në Landovicë (I përfunduar);
6. Ndërtimi i aneksit të shkollës në Vermicë. Punimet pritet të përfundojnë gjatë tremujorit të fundit të vitit 2024;
7. Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën "Haziz Tola" në Lagjen Jeta e Re - Prizren - faza e dytë (E përfunduar);
8. Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën "Fatmir Berisha" në Lagjen Bajram Curri - Prizren - faza e dytë. Punimet pritet të përfundojnë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024;
9. Ndërtimi i aneksit të shkollës së mesme në Romajë – Has. Punimet pritet të përfundojnë deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2024;
10. Renovimi i objektit shkollor "Gërnqare" Novoselan. Punimet janë në fazën përfundimtare;
11. Renovimi i tërësishëm i sallës së edukatës fizike "Meto Bajraktari" në Reçan. Punimet do të përfundojnë në tremujorin e tretë të vitit 2024;
12. Ndërtimi i çerdhes në fshatin Zhur, Prizren - Projekti për momentin është në pritje deri në hartimin e projektit zbatues. Punimet do të zgjasin deri në vitin 2026;
13. Ndërtimi i çerdhes në lagjen Arbana, Prizren - Projekti për momentin është në pritje deri në hartimin e projektit zbatues. Punimet do të zgjasin deri në vitin 2026;
14. Ndërtimi i aneksit për ciklin parashkollor në SHFMU "Motrat Qiriazhi" në Prizren - Projekti i planifikuar të fillojë nga viti 2024 duhet analizuar përsëri, pasi nuk ka kushte dhe hapësirë të mjaftueshme për ndërtim.
15. Renovimi i tërësishëm i objektit shkollor (aneksit të vjetër) "Naim Frashëri" Vlashnje (I përfunduar);

Investimet në mjedise shkollore:

1. Janë realizuar punimet në rregullimin e ambienteve të oborreve në shkollat “Zenun Çoçaj” në Gjonaj, “Dëshmorët e Kabashit” në Korishë dhe “Gani Saramati” Prizren.
2. Ndërtimi i aneksit të shkollës "Besim Ndrecaj" Lutogllavë – Punimet do të zgjasin deri në vitin 2026.
3. Është në proces renovimi i objektit shkollor i SHF "Lekë Dukagjini" Prizren – Punimet do të zgjasin deri në tremujorin e tretë të vitit 2024.
4. Ndërtimi i çerdhes në Lagjen e Trimave (Tusus) Prizren – Punimet do të zgjasin deri në vitin 2026.
5. Renovimi i tërësishëm i objektit shkollor "Mati Logoreci" Prizren - Projekti është në pritje deri në hartimin e projektit zbatues. Punimet do të zgjasin deri në vitin 2025.
6. Renovimi i nyjeve sanitare në objektet shkollore “Ibrahim Fehmiu” në Prizren dhe “Dëshmorët e Kabashit”. Projekti është në procedurë ofertimi-tenderimi. Punimet do të zgjasin deri në vitin 2025.
7. Ndërtimi i terrenit sportiv dhe murit mbrojtës në shkollën "Dëshmorët e Zhurit" në Zhur. Punimet mund të zgjasin deri në vitin 2025.
8. Ndërtimi dhe rregullimi i stadiumit në shkollën "Meto Bajraktari" në Reçan. Projekti është në fazën e prokurimit dhe punimet do të zgjasin deri në vitin 2025.
9. Ndërtimi i këndit të lojërave në SHFMU "Motrat Qiriazi" në Prizren. Projekti është në pritje deri në hartimin e projektit zbatues.
10. Ndërtimi i ashensorit në SHFMU "Motrat Qiriazi". Projekti është në pritje deri në hartimin e projektit zbatues.
11. Ndërrimi i kalldajave të ngrohjes qendrore, montimi i pompave termike në SHFMU "Motrat Qiriazi". Projekti është në pritje deri në hartimin e projektit zbatues.
12. Punimi i terrenit sportiv dhe rrethojës së oborrit në SHFMU "Naim Frasheri", Kobaj. Projekti është në pritje deri në hartimin e projektit zbatues.
13. Digjitalizimi i sistemit të institucioneve arsimore në shkollat: “Emin Duraku”, “Mati Logoreci”, “Lekë Dukagjini”, “Abdyl Frashëri”, “Hysen Rexhepi”, “Gani Saramati”, “Ibrahim Fehmiu”, “Fadil Hisari”. Projekti është në pritje të kompletimit të dokumentacionit-materialit për ofertim.
14. Rregullimi i kabineteve të shkencave në gjimnazin “Gjon Buzuku” dhe shkollat “Motrat Qiriazi” e “26 Marsi”.
15. Gjatë vitit 2024 janë planifikuar edhe 5 projekte të tjera:
16. Hartimi i projekteve të ndryshme për nevojat e DKA-së, për vitin 2024 e planifikuar në vlerë prej 100,000.00€. Projekti është në fazën e ofertimit-ankesave.
17. Mirëmbajtja e sistemit të ngrohjes qendrore nëpër instucionet arsimore të Komunës së Prizrenit. Për vitin 2024 e planifikuar në vlerë prej 100,000.00€.

18. Rregullimi dhe mirëmbajtja e ambientit të oborreve të shkollave në Komunën e Prizrenit - kontratë kornizë. E planifikuar për tri vite, në vlerë prej 1,500,000.00€. Projekti është në fazën e ofertimit-ankesave.
19. Lyerja e brendshme dhe e jashtme (fasadave) të institucioneve arsimore. E planifikuar për tri vite, në vlerë prej 600,000.00€. Projekti është në fazën e ofertimit.
20. Furnizimi me inventar shkollor për institucionet arsimore. Për vitin 2024, e planifikuar në vlerë prej 95,000.00€. Projekti është në fazën e ofertimit-ankesave.

4. Drejtorja e Shëndetësisë

Gjatë kësaj periudhe, nga kategoria e investimeve kapitale, ka përfunduar:

1. Furnizimi me aparatura mjekësore,
2. Furnizimi me paisje stomatologjike.

Në projektet kapitale që janë në vazhdim e sipër, hyjnë:

1. Ndërtimi i QKMF-së të ish kampi i KFOR-it,
2. Ndërtimi i QMF-së në fshatin Korishë.

Për projektet e tjera kapitale, përfshirë këtu ndërtimin e QMF-së në Lagjen e Trimave (Tusus), blerjen e mamografit, blerjen e autoambulancave, etj, janë iniciuar procedurat përkatëse dhe deri në përfundim të vitit pritet përfundimi i tyre.

Në kuadër të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, përveç projekteve që kanë të bëjnë me furnizimet me materiale të domosdoshme për punën e rregullt të QKMF-së, siç janë furnizimi me reagenca, furnizimi me filma RTG, furnizimi me material higjienik, sanitar e barna, furnizimi me material administrativ, uniforma të punës, etj, vlen të ceken projektet:

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për mbulimin e kërkesave dhe nevojës për staf shtesë të QKMF-së, kontratë e nënshkruar me Organizatën Caritas, në kuadër të së cilës përveç shërbimeve të rregullta shëndetësore, është i organizuar edhe kujdesi shtëpiak, projekt i cili ka qenë në vazhdim deri më 31 maj 2024.

Mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve shëndetësore, ku janë renovuar shumë njësi shëndetësore në të cilat janë përmirësuar kushtet e punës, siç janë: AMF Lubizhdë e Hasit (rifunksionalizim), AMF Skorobisht, AMF Mushnikovë, Bodrumi i QKMF-së, QMF - Hoqë e Qytetit, QMF - Jeta e re, QMF - Tusus, QMF - Zhur, QMF 11 Marsi, QMF - Kurilë, QMF - Lakuriq, Urgjencë, etj.

Për të gjitha projektet e tjera të parapara janë iniciuar procedurat përkatëse tenderuese.

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur në proces të auditimit projektin me Caritas për blerje të shërbimeve shëndetësore, ku pas përfundimit të auditimit nga ZKA-ja lidhur me projektet e realizuara për blerjen e shërbimeve shëndetësore gjatë viteve 2018-2022, kemi pranuar draft raportin nga ana e ZKA-së lidhur me të gjeturat e auditimit për projektin e kontraktimit të shërbimeve shëndetësore me Caritas, draft për të cilin edhe i kemi përcjell vërejtjet tona të cilat janë pranuar si të mirëqena nga ZKA-ja.

Sa i përket shërbimeve shëndetësore, gjatë kësaj periudhe, QKMF-ja ka ofruar numër të madh të shërbimeve shëndetësore. Ky numër arrin shifrën **386,684** shërbime shëndetësore, duke përfshirë por shërbimet si: vizita specialistike mjekësore, vaksinim, analiza laboratorike, rtg, shërbime urgjente, shërbime geriatrike, shërbime të kujdesit paliativ, shërbime stomatologjike, vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë, teste rapide, EKG, fashime, inhalime, injeksione, infuzione, këshillime, udhëzime, etj.

Në këtë periudhë ka filluar dhe përfunduar realizimi i vizitave sistematike mjekësore në shkolla për nxënësit e klasave 1, 5 dhe 9 në Komunën e Prizrenit.

Në kuadër të shënimit të Ditëve Botërore, me aktivitete të ndryshme, përfshirë ligjerata, shpërndarje të fletushkave, aktivitete në Sheshin Shatërvan, etj., janë shënuar këto ditë:

1. Dita Botërore e Kancerit;
2. Dita Botërore e Tuberkulozit;
3. Dita Botërore e Shëndetit;
4. Java Botërore e Imunizimit;
5. Dita Botërore e Hipertensionit;
6. Dita Botërore e Duhanit;

Në këtë periudhë ka filluar edhe pranimi i dokumentacioneve për mbështetje financiare për kategoritë e përcaktuara në rregulloren për ndarjen e subvencioneve. Nga janari deri në maj 2024, janë parashtruar rreth 750 kërkesa për mbështetje financiare nga këto kategori. Prej tyre, deri më tani janë aprovuar 641 kërkesa të parashtruara gjatë muajve mars dhe prill në shumën totale prej 256,800.00 euro.

Gjithashtu, është realizuar pagesa për 271 persona kërkesat e të cilëve janë pranuar më 2023, mirëpo si shkak i mungesës së mjeteve financiare më 2023 janë përcjellur për realizim në vitin 2024. Shuma që është ndarë për këta persona kap vlerën e 108,400.00 eurove.

5. Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor

Disa nga projektet kryesore janë:

1. Rehabilitimi i kulmeve dhe korridoreve në objektet e banimit kolektiv

Është bërë përzgjedhja e objekteve ku do të bëhet rehabilitimi i kulmeve dhe korridoreve - tani është në fazën e tenderimit.

Sigurimi i kushteve optimale për banorët dhe përmirësimi i pamjes urbanistike të lagjeve ku janë banimet kolektive.

2. Hartimi i PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL (PZHK)

Është dokument shumë me rëndësi me të cilën DUPH-ja do të punoj një kohë të gjatë ku do të përcaktohen zonat e zhvillimit të pjesës urbane dhe rurale, me Ligjet, përkatësisht Udhëzimet Administrative që e rregullojnë sferën e planifikimit dhe ka arritur deri te hartimi i profilit urban.

3. Hartimin e planit rregullues urban për zonën e veçantë - Parku i Biznesit

Plani rregullues urban për zonën e Veçantë – Parku i Biznisit ka kaluar fazën e tenderimit dhe ka arritur deri në shqyrtim publik.

6. Drejtoria e Inspektorateve

Aktivitetet kryesore:

- Shqyrtimi i lëndëve me problematikë të ndërtimit si: mbikëqyrja e projekteve, mbikëqyrja e objekteve, pjesëmarrja në komisione profesionale;
- Lirimi i hapësirave publike të cilat në mënyra të ndryshme shfrytëzohen nga bizneset dhe qytetarët, largimi i pengesave të ndryshme reklamave lëvizëse dhe statike nga këto hapësira, mbrojtjen nga dëmtimi i hapësirave publike;
- Kyçjet ilegale në rrjetin publik të ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Inspektimi i bizneseve që shfrytëzojnë hapësirat publike para lokaleve afariste me tavolina e karrige si dhe ekspozimin e mallrave dhe shitësit ambulantiv;
- Pastërtia e qytetit;
- Monitorimi i Lejeve Mjedisore Komunale – LMK, lejeve të lëshuara nga MMPHI, inspektimet e eksploatimit të zhavorit në shtratin dhe brigjet e lumenjëve dhe eksploatimin e gurëve në Gurorë që gjenden në Komunën e Prizrenit;

- Inspektimi i transportit publik të udhëtarëve, me theks të veçantë mbikqyrjen rreth zbatimit të ndryshimit të trasesë së qarkullimit të mjeteve të transportit publik të udhëtarëve;
- Bashkëpunimi me kompanitë publike siç janë Eko-Regjioni dhe Hidroregjioni, si dhe me Policinë e Kosovës;
- Mbikëqyrja e tregut, konkurrenca lojale, mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja nga dëmtimi material, fizik dhe shëndetësor;
- Shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve dhe zgjidhja e tyre, saktësia në matjen e produkteve përmes peshoreve dhe mbushjes së karburanteve, vulosja e njësive matëse si dëshmi për saktësinë nga Agjencia e Metrologjisë i Kosovës,

Disa shembuj-ilustrime me foto të aktiviteteve:

- Ndërprerja e ndërtimeve pa leje si: objekte afariste, banim kolektiv, shtëpi banimi, depo, objekte të karakterit të përkohshëm, kiosqe etj.



- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje si: objekte afariste, banim kolektiv, shtëpi banimi, depo, objekte të karakterit të përkohshëm, kiosqe etj.



- Rrënimi i objekteve, demolimi/rrënimi i objekteve me karakter të përkohshëm, konstruksionet metalike/drurit etj., të ndërtuara pa leje ndërtimore nga organi kompetent në hapësirat publike dhe private.



Inspektimi i punimeve: hapja e rrugës fushore në fshatin Zhur



Largimi i pengesës në rrugën “Gani Saramati”



Lirimi i hapësirës publike te rruga Transiti i Vjetër te rreth-rrotullimi për Autostradë

Procedurat e zhvilluara gjatë mbikëqyrjes inspektive të Sektorit të Ndërtimit

- Procesverbale – 339
- Aktvendime - 79
- Ekzekutime - 3
- Kallzime penale - 6
- Njoftime, konstatime – 10
- Gjoha mandatorë në vlerë të përgjithshme - 14,500 €
- Gjobat mandatore të paguar gjatë këtij viti - 3,550 €

Procedurat e zhvilluara gjatë mbikëqyrjes inspektive të Sektorit të Tregut

- Janë hartuar procesverbale – 545

- Janë lëshuar aktvendime me urdhëresa – 212
- Janë dhënë pëlqime për ushtrimin e veprimtarisë afariste – 115
- Janë iniciuar në gjykatën kompetente (gjoba) - 26
- Janë asgjësuar produkte joushqimore, gjatë punës në terren,
- Janë asgjësuar produkte joushqimore me kërkesën e palës, vlera në - 7,446.63 €
- Janë shqyrtuar ankesat- reklamacionet e konsumatorëve - 22
- Plotësimi i kërkesave të gjykatës - 2
- Ndalimi i veprimtarisë afariste, përkohësisht
- Gjoba nga Gjykata - 15,350.00 €
- Bashkëpunimi me Policinë, raste – 20.

7. Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri

Aktivitetet e drejtorisë:

- Vendosja dhe mirëmbajtja e kamerave të sigurisë në Komunën e Prizrenit (janë hapur ofertat).
- Blerja e motorave special për Brigadën e Zjarrfikësve (janë hapur ofertat).
- Pajisje për brigadën e zjarrfikësve (janë hapur ofertat).
- Ndërtimi i mureve mbrojtëse nga rrëshqitjet e dheut.

Subvencionet:

Janë subvencionuar të gjithë qytetarët të cilët kanë kërkuar mbështetje financiare të cilët janë dëmtuar nga zjarri në vlerë prej 30,500.00.

Intervenimet nga Shërbimi i Zjarrfikësve

- Numri i zjarreve 145
- Numri i Intervenimeve teknike 32
- Është bërë verifikimi i hidranteve dhe ashensorëve në qytet dhe objekte: Spitalin Rajonal, PTK, Objektet e KEK-ut, Shkollat, Qendrat Tregtare etj.

Inspektorët e Preventivës:

- Pëlqime - 38
- Pranime teknike në objekte – 4
- Hulumtime në kushte minimale Teknike – 4
- Hulumtime dhe procesverbale – 12

8. Drejtoria e Administratës


Njëra ndër objektivat kryesore të Drejtorisë së Administratës ka qenë Zgjedhja e Bashkësive Lokale që ka përfunduar me sukses.




Renovimi i objekteve të Komunës:

1. Renovimi i objektit të zjarrfikësve.
2. Furnizimi me gjeneratorë për nevojat e drejtorive
3. Përfundimi i pjesës më të madhe të punimeve në terasat e Shtëpisë së Bardhë
4. Sinjalizimi dhe vendosja e laurave në parkingun te objekti i Administratës
5. Mbështetja e organizimeve të Epopeve të ndryshme
6. Furnizimi me dru dhe pelet i të gjitha objekteve nën mbikqyrjen e Drejtorisë së Administratës
7. Renovimi i objektit të batalionit të Zjarrfikësve.

Foto nga renovimet e bëra:





- Dekorimi i qytetit me flamuj për festa:
- Është bërë vazhdimisht furnizimi me flamuj për nevojat e komunës dhe dekorimi i qytetit për datat festive.

Aktivitet e filluara për të cilat kanë përfunduar procedurat tenderuese:

- Renovim i katit të parë për zyrat dhe hapësirat punuese për Drejtorinë e Urbanizmit,
- Vazhdimi i memorialit në fshatin Krushë e Vogël,
- Përfundimi i ndërtimit të varrezave të Martirëve në fshatin Krushë e Vogël,
- Ndërtimi i pllakës përkujtimore te Familja Batusha.

Sektori IT-së është kujdesur që të kemi sistemin e rregullt në zyrë, instalime të versioneve të fundit të programeve, intervenime në baza ditore, mbështetje teknike etj.

Sektori i Gjendjes Civile:

Sektori i gjendjes Civile Prizren	Gjithësej
Ekstrakt të lindjes	49701
Certifikata të lindjes	18425
Certifika të martesës	9459
Certifikata të vdekjes	4005
Certifikata të statusit martesor	2459
Certifikata të vendbanimit	4296
Certifikata të shtetësisë	518
Certifikatë e vërtetimit nga arkivi	1439
Deklaratë Bashkësisë Familjare	2881
TOTALI I CERTIFIKATAVE:	93183
Akt Vdekje-Dëshmi vdekjeje	269
Kërkesë për Lirim nga Shtetësia	033
Kërkesa për Fitim të Shtetësisë	083
Regjistrime të Lindjes të Rregullta	639
Regjistrime të Lindjes të Veçanta	320
Regjistrime të martesave të Rregullta	693
Regjistrime të martesave të Veçanta	123
Regjistrime të vdekjes të Rregullta	583
Regjistrime të vdekjes të Veçanta	73
Vendime për korrigjime, ndërrime dhe regjistrime suplementare	241
TOTALI I SHËRBIMEVE ME PROCEDURË:	3057

9. Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit

Gjatë kësaj periudhe kemi pranuar 9856 kërkesa në kuadër të sektorit të gjeodezisë dhe kadastrit. Të përfunduara gjithsej 9.253 kërkesa, brenda afateve ligjore. Ndërsa 347 kërkesa janë në proces-shqyrtim, 164 janë refuzuar, 22 janë anuluar dhe 67 janë pezulluar.

Në këtë periudhë nga shërbimet e lartë përmendura janë grumbulluar të hyra prej 177,810 euro - 35.56% e të hyrave kësaj drejtorie.

Aktivitetet më të rëndësishme që janë marrë në këtë periudhë janë:

- **Legalizimi:** Janë regjistruar 114 vendime të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor sipas ligjit për ndërtimet pa leje dhe të gjitha këto objekte tani janë të evidentuara në regjistrat kadastrale, ku për secilën ekzistojnë certifikata të pronës.
- **Shpronësimet:** Një ndër projektet më të rëndësishme janë: Varrezat e Qytetit, krijimi i hapësirave për lëvizshmëri në trafik dhe për këmbësorë e cila përfshinë rrënimin e objektit që shtrihet në pjesën e parcelës 4792-0 ZK Prizren (NTSH 'Liria').

- **Piketimet:** Gjatë afatit raportues sipas kërkesave të Drejtorive janë kryer piketimet e rrugëve, objekteve komunale dhe hapësirave publike.
- **Matjet Gjeodezike:** Janë bërë matjet në terren sipas kërkesave të drejtorive për incizimet e gjendjeve faktike dhe projektet të cilat janë kërkuar nga drejtoritë përkatëse.

10.Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Disa nga projektet kryesore:

Ndërtimi i shtëpisë për të moshuar (vazhdim i projektit)




Ndërtimi i Qendrës për Punë Sociale 2 (QPS 2)



Projekti Ndërtimi i banesave sociale në Lagjen Petrovë Kulla 4 (Vazhdim i projektit)



Renovimi i banesave kolektive në Lagjen Petrovë Kulla 3 (Vazhdim i projektit)



- Ndërtimi i shtëpive për familjet me vështirësi ekonomike dhe rastet sociale – projekt që është miratuar, është ndarë parcela e cila gjendet në Lagjen e Trimave, në bashkëpunim me shoqatën “Jetimët e Ballkanit” do të bëhet ndërtimi i 50 shtëpive për këto kategori.
- Ndërtimi i kulmeve për familjet skamnore - projekt i miratuar dhe është në fazën e thirrjes publike për aplikim, ku pas aplikimit do të bëhet vlerësimi i kostos financiare.
- Ndërtimi i shtëpisë emergjente për mbrojtjen e fëmijëve. Në këtë projekt është ndarë parcela ku do të ndërtohet objekti. Vlera e paraparë për këtë investim kapital për këtë vit është 230.000,00 Euro dhe është në fazën e hartimit të projektit.

Projektet tjera: Përveç projekteve kapitale, DPMS-ja për realizimin e objektivave realizon edhe këto projekte;

- Furnizimi me medikamente për shtëpinë me bazë në komunitet për persona me aftësi të kufizuara;
- Furnizimi me ushqim dhe pije për shtëpinë me bazë në komunitet për persona me aftësi të kufizuara;
- Furnizim me veshmbathje për shtëpinë me bazë në komunitet për persona me probleme të shëndetit mendor dhe shtëpisë së të moshuarve;
- Blerje e frigoriferëve, televizorëve dhe pajisjeve të tjera për shtëpinë rezidenciale
- Hartim i projekteve të ndryshme për DPMS-së;
- Shërbime transporti për bartjen e fëmijëve dhe familjarëve të tyre me vështirësi sociale
- Mbikëqyrje e punimeve të projekteve të DPMS-së;
- Furnizim me produkte hixhienike për shtëpinë rezidenciale;
- Mbulimi i shpenzimeve të varrimit për të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit.

Subvencionet:

- Subvencionimi i realizimit të projekteve të OJQ-ve dhe individëve në fushën e shërbimeve sociale - vlera e paraparë për subvencionim është 60.000.00 euro;
- Subvencionimi i familjeve strehuese - vlera e paraparë për këtë kategori është 25.000.00;

- Subvencionimi i rasteve të rënda sociale - vlera e paraparë për këtë kategori është 50.000.00 euro;
- Subvencionimi i familjeve me vështirësi ekonomike me pagesë të qirasë – pas aplikimit komisioni ka përzgjedhur 26 familje të cilat do të përfitojnë nga pagesa e qerasë;
- Subvencionimi i familjeve me pagesën e qerasë për familjen e Qelebije Gashit dhe Skender Karaqit. Këto dy familje kanë jetuar në objektin e ish Konsullatës Austro-Hungareze, objekt i cili është në procedurë të rikonstruktimit.

Strategjitë komunale:

- Strategjia komunale për persona me aftësi të kufizuar në Komunën e Prizrenit
- Plani i punës për ekipin për të Drejtat e Fëmijës në Komunën e Prizrenit 2024-2026

Banimi Social: Objekteve komunale të cilat shfrytëzohen si objekte për banim të veçantë në kuadër të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale momentalisht janë 240 njësi banesore dhe 142 familje.

Shërbimet Sociale Familjare: Komuna ofron shërbime sociale për familje, fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë të braktisur, viktima të dhunës etj.

Skema e asistencës sociale: Nga kjo skemë përfitojnë 665 familje në muajin janar 2024, deri në 673 familje në muajin Maj 2024 - totali 389.750.00 Euro.

11.Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik

Disa nga projektet kryesore janë:

Investimet në fshatin Poslisht

Investimet në këtë zonë janë bërë me qëllim që Turizmi të posedoj një destinacion të ri turistik, me qëllim të promovimit dhe ngritjes së kapaciteteve të pasurive që i posedojmë.



Investime në fshatin Leskovec – Kalaja e UÇK – së



Investime në fshatin Kabash – Korishë

Investimet në këtë zonë janë investime që kanë karakter të zhvillimit të potencialit të turizmit malor dhe rural: “Krijimi i ambientit turistik në Malet e Kabashit dhe të Korishës”.




Investime në fshatin Nashec

“Rregullimi i ambientit në fshatin Nashec”



Hapja e rrugëve malore në Zhur

- 14.28km ishte aktuale në rreth, me trasenë e re është 2.5 herë më e shkurtuar,
- Ka krijuar mundësi të qasjes më të lehtë në pyje dhe toka pyjore,
- Rritje të interesit për pronarët e pyjeve, livadheve dhe të tokave pyjore shtetërore,
- Shtimi i mundësive dhe kapaciteteve blegtoriale.



2. Ndërtimi i shtigjeve për biçiklistë

Drejtoria për mbështetje të organizatave të çiklistëve si rrugor ashtu edhe ato malor, ka bërë investime në shtegun të ri në fshatin Vlashnje dhe shtegun për ofertën turistike të Doënhill – it nga Cvileni deri në Kala dhe Pashaqeshme.

3. Ndërtimi i infrastrukturës (rrugë, ujë, kanalizim) Kisha e Shën Pjetrit – Kabash, Korishë dhe Gurri i Kallugjerit Jeshkovë - Billushë.
4. Ringjallja e zejeve dhe ndërtimi i kulturës për Zhvillimin e Përbashkët Turistik që është projekt duke u implementuar në bazë të marrëveshjes së Komunës së Prizrenit, Komunës së Tetovës, Ceed Maqedonisë dhe Ceed Kosovës, i financuar nga Bashkimi Evropian.

Aktivitete të tjera:

Drejtorja e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik zhvillon edhe trajnime profesionale, ku deri më tani rreth 70 persona kanë marrë trajnim profesional pa pagesë.

Mbështetjen më anë të participimit – është mundësuar sigurimi i hapësires për promovim, duke marrë pjesë në:

1. Panairin e Turizmit Ndërkombëtar – të mbajtur në Prishtinë (SHTAK),
2. Panairi Ndërkombëtar i Turizmit dhe i Sportit.



- Panairi Tradicional i Turizmit

Drejtorja për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik ka organizuar dhe ka mbajtur Panairin Tradicional të Turizmit, në të cilin është bërë promovimi i produkteve artizanale, veshjeve kombëtare si dhe produkteve vendore. Në kuadër të këtij panairi është bërë organizimi dhe mbajtja e koncertit në të cilin kanë performuar këngëtarë të njohur.



- **Subvencionet:** Shuma totale e mbështetjes financiare me anë të subvencioneve është 110.000 euro.
- **Punëtori:** Punëtorja e realizuar nga Swisscontact-i dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës me tematikë “Përditësimi i Strategjisë për Turizëm të qëndrueshëm”,

- Punëtorja e realizuar nga AZHR-ja dhe drejtorët komunalë si pjesë e grupit punues me temën “Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal”,
- Pjesëmarrja në panairin e Turizmit në Grenoble të Francës, ku qëllimi ishte edhe shkëmbimi i ideve të llojeve të teleferikut që janë të përshtatshme për Komunën e Prizrenit.



12. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Aktivitetet kryesore:

- Shfrytëzimi racional i tokës bujqësore dhe mbrojtja nga ndërrimi i destinimit të pa planifikuar dhe aktivitetet tjera që kanë qëllime jo bujqësore;
- Hartimi dhe zbatimi i Programit për Investime kapitale/subvencione/shërbime;
- Organizimi i shërbimeve këshillimore dhe trajnimeve në aplikimin e mbrojtjes së integruar sipas veprimtarive prodhuese bujqësore;
- Furnizimi me pajisje të ndryshme bujqësore varësisht nga veprimtaria.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar gjithsejtë 128 kërkesa me shkrim nga lëmi të ndryshme, prej tyre 77 janë miratuar, 20 janë në proces, 5 janë hedhur poshtë, 9 janë refuzuar dhe 17 janë pezulluar.

Projektet kapitale:

1. Rehabilitimi i kanaleve ujitëse dhe pastrimi i kanaleve kulluese,
2. Rehabilitimi i rrugëve fushore.

Subvencionet: Shuma totale e subvencioneve është **661,122.90 Euro**

1. Ngritja e serrave,
2. Ngritja e pemishteve me pemë të imta – dredhëza,
3. Ngritja e pemishteve me pemë të imta – boronica,
4. Ngritja e stallave për lopë qumështore,
5. Furnizimi me mëshqerra gravide (5-7 muajshe),
6. Hapja e puseve.

Aktivitetet e tjera shërbyese:

1. Trajtimi i qenve endacak,
2. Pjelloria e tokës dhe rekomandimet për plehrim,
3. Insemenimi artificial i lopëve dhe vaksinimi i deleve,
4. Vaksinimi kundër brucelozës,
5. Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i qytetit.

13.Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Disa nga projektet kapitale:

1. Ndërtimi i objekteve kulturore, rinore dhe sportive (kanë filluar punimet);
 - a) Ndërtimi i fushave sportive: Futboll, Volejboll dhe basketboll në fshatin Planejë;
 - b) Renovimi i tërësishëm i sallës sportive në fshatin Medvec;
 - c) Vendosja e rrethojave në fushën e sportit në fshatin Kushnin;
 - d) Ndërtimi i fushave sportive: Futboll, Volejboll dhe basketboll në fshatin Atmaxhë;
 - e) Ndërtimi i fushave sportive: Futboll, Volejboll dhe basketboll në lagjen Bajram Curri;
 - f) Ndërtimi i fushave sportive: Futboll, Volejboll dhe basketboll në fshatin Billushë;
 - g) Ndërtimi i fushave sportive: Futboll, Volejboll dhe basketboll në fshatin Zhur.
2. Ndërtimi i qendrës kulturore në fshatin Pouskë (kanë filluar punimet);
3. Inventarizimi i objekteve kulturore, rinore dhe sportive (në proces të prokurimit);
4. Pas nënshkrimit të kontratës “Renovimi i Lapidarëve në Komunën e Prizrenit”, bazuar në kërkesat e lokaliteteve, operatori ekonomik ka filluar punën në këtë drejtim;
5. Kanë përfunduar procedurat e prokurimit për projektin “Renovimi i Qendrës kulturore-rinore në Ortakoll” - bashkëfinancim me USAID-in, projekt i përzgjedhur në kuadër të Kontratës Sociale;
6. Zhvendosja e gypave dhe puseta të ujit te salla multifunksionale (kanë filluar punimet);
7. Mbikëqyrja e projekteve të DKRS-së, kanë filluar procedurat tenderuese (projekt 2024-2026);
8. Ndërtimi i Kullës “Remzi Ademaj” – Zhur (në fazën përfundimtare);
9. Renovimi i Qendrës Sportive “Sezai Surroi” - izolimi i jashtëm dhe dritaret - kanë përfunduar procedurat tenderuese;
10. Restaurimi i Kullës në Gjonaj – projekti është në procedim;
11. Renovimi i Shtëpisë së Kulturës në fshatin Hoqë e Qytetit (aktualisht projekti është në OSHP dhe shumë shpejtë pritet një përgjigje për fillimim e renovimit);

12. Punimi i bustit të Heroit të Kosovës "Xhevat Berisha" (kanë përfunduar procedurat tenderuese);
13. Monitorimi i OJQ-ve kulturore, rinore dhe sportive (kanë përfunduar procedurat tenderuese);
14. Nërtimi i Lapidarit "Xhavit Elshani-Leopardi" (kanë filluar punimet);
15. Ndërtimi i Sallës Multifunkionale (janë duke vazhduar punime me intesitet të lartë);
16. Ndërtimi i varrezave të martirëve në Landovicë (punimet janë në fazën përfundimtare);
17. Ndërtimi i Qendrës Kulturore-Rinore Turke (në fazën përfundimtare të ndryshimit të projektit ngase ka pasur tejkalime në projekt dhe shumë shpejtë pritet të vazhdoj projekti.
18. Renovimi e Shtëpisë së Kulturës "Xhemajli Berisha" (punimet janë në fazën përfundimtare);
19. "Renovimi i Këndit Amerikan dhe bibliotekës ekzistuese në fshatin Zym" (kanë përfunduar punimet dhe objekti vetëm do të përrurohet);
20. Ndërrimi i ormanit të rrymës te Qendra Sportive (kanë përfunduar punimet);

Subvencionet: Ka përfunduar procesi për mbështetje financiare për OJQ-të kulturore, rinore dhe sportive - faza e parë për vitin 2024 (Vlera totale e mbështetjes 1,398,000 €);

Aktivitete të tjera:

- Ka filluar puna në procesin e Rregullores për dhënien në menaxhim dhe shfrytëzim të objekteve kulturore, rinore dhe sportive;
- Kanë vazhduar pagesat për marrëveshjen me Eko Regjionin;
- Organizimi i festës së 17 shkurtit - Përvjetori i Pavarësisë së Kosovës;
- Organizimi i festivalit për fëmijë "Fluturat 2024" - 1 Qershor;
- Festivali Folklorik për Fëmijë "URA 2024" 8 dhe 9 Qershor;
- Organizimi i festave: 10 Qershor LSHP dhe 12 Qershor Dita e Çlirimit të Prizrenit;

Kryetari i Komunës së Prizrenit,

Shaqir Totaj

